



Data: 07.03.2019

Ref.: 390/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 63-të, të mbajtur më 27 shkurt 2019, mori:

V E N D I M

Për korigjimin (përmirësimin) e vendimit të KSHC-së Nr.471/18D, datë 18.05.2018

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa (Nr.1285/18h, datë 08.10.2018) e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti Ekonomik për përmirësim të vendimeve të KSHC-së, Nr.471/18d, datë 18.05.2018.
- II. Korigjohet (përmirësohet) pika I dhe II e vendimit të KSHC-së Nr. 471/18d, datë 18.05.2018, si në vijim: Përmirësohen gradat shkencore nga BA në BSc, dhe nga MA në MSc për tri programet e studimit si më poshtë:
 - Ekonomiks, BA, 180 ECTS, përmirësohet në: Ekonomiks, BSc, 180 ECTS;
 - Ekonomiks, MA, 120 ECTS, përmirësohet në: Ekonomiks, MSc, 120 ECTS, dhe
 - Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS, përmirësohet në: Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment, BSc, 180 ECTS.
- III. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr. 471/18D, datë 18.05.2018 mbetet në fuqi.
- IV. Anullohet vendimi për përmirësim të vendimit Nr.1562/18D, datë 07.11.2018.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka parashtruar kërkesë (nr. 1285/18H, datë 08.10.2018) për përmirësim të vendimit të KSHC-së Nr. 471/18d, datë 18.05.2018, në pikën I dhe II. Bazuar në kërkesën e cekur më sipër, dhe nenin 50 (Korigjimi i gabimeve të dukshme në një akt



Data: 07.03.2019

Ref.: 390/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 63-të, të mbajtur më 27 shkurt 2019, mori:

V E N D I M

Për korrigjimin (përmirësimin) e vendimit të KSHC-së Nr.471/18D, datë 18.05.2018

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa (Nr.1285/18h, datë 08.10.2018) e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti Ekonomik për përmirësim të vendimeve të KShC-së, Nr.471/18d, datë 18.05.2018.
- II. Korrigjohet (përmirësohet) pika I dhe II e vendimit të KSHC-së Nr. 471/18d, datë 18.05.2018, si në vijim: Përmirësohen gradat shkencore nga BA në BSc, dhe nga MA në MSc për tri programet e studimit si më poshtë:
 - Ekonomiks, BA, 180 ECTS, përmirësohet në: Ekonomiks, BSc, 180 ECTS;
 - Ekonomiks, MA, 120 ECTS, përmirësohet në: Ekonomiks, MSc, 120 ECTS, dhe
 - Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS, përmirësohet në: Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment, BSc, 180 ECTS.
- III. Pjesa tjetër e vendimit të KShC-së Nr. 471/18D, datë 18.05.2018 mbetet në fuqi.
- IV. Anullohet vendimi për përmirësim të vendimit Nr.1562/18D, datë 07.11.2018.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi


Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka parashtruar kërkesë (nr. 1285/18H, datë 08.10.2018) për përmirësim të vendimit të KSHC-së Nr. 471/18d, datë 18.05.2018, në pikën I dhe II. Bazuar në kërkesën e cekur më sipër, dhe nenin 50 (Korrigjimi i gabimeve të dukshme në një akt

administrativ) të Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative (Ligji Nr. 05/L -031 25 maj 2016), Agjencia e Kosovës për Akreditim ka trajtuar kërkesën në fjalë, dhe pas kontrollimit në detaje të aplikacionit e parashtruar nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për ri-akreditim të programeve të studimit të cekura më sipër dhe rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit në Raportit Final të cilët kanë vlerësuar programet e studimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi u dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina, Fakulteti Ekonomik;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

